



Datë: 26.01.2026
Numër Protokolli: 422/2026

A.nr.1868/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi-Prenaj, si procesmbajtëse, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1868/2025, të datës 05.11.2025, të parashtruar nga ankuesi, G.H kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 26.01.2026, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.1868/2025, të datës 05.11.2025, të parashtruar nga ankuesi, G.H.

A r s y e t i m

Kandidati për pranim në shërbim civil, G.H (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), më datë 04.11.2025, përmes postës elektronike (ankesa.kpmshck@rks-gov.net), ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e pranuar në Këshill më datë 05.11.2025, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016741, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, pozita e punës “*Zyrtar për Regjistrim Civil*”, në Agjencinë e Regjistrimit Civil në Ferizaj, të shpallur nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa, kjo e fundit, ka përcjellë përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë përmbushur kushtet për përfundim të procedimit administrativ të filluar sipas ankesës A.nr.1868/2025, **sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Punëve të Brendshme, më datë 14.02.2025, ka shpallë konkursin me numër reference RN00016741, për Grupin e Administrimit të Përgjithshëm, respektivisht për pozitën e punës “Zyrtar për Regjistrimin Civil”, në Agjencinë e Regjistrimit Civil në Ferizaj, me klasë të pozitës Profesional 2, një vend i lirë pune, i hapur për aplikim nga data 15.02.2025 deri më datën 16.03.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi dhe se i njëjti i është nënshtruar vlerësimit profesional, gjegjësisht, ankuesi në testin me shkrim është vlerësuar me 51.2 pikë, ndërsa në intervistën me gojë me 12.4 pikë, gjithsej 63.6 pikë, mirëpo, sipas renditjes përfundimtare të rezultateve të vlerësimit nga Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ankuesi është renditur si kandidati i dytë me më së shumti pikë të arritura, rrjedhimisht si kandidatë me më së shumti pikë rrjedhë të jetë I.B me gjithsej 70.2 pikë, (58.6 pikë në testin me shkrim dhe 11.6 pikë në intervistën me gojë), ashtu që i njëjti është shpallur edhe si kandidatë fitues sipas Njoftimit të datës 09.10.2025, të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Pas publikimit të Njoftimit të rezultateve, ankuesi ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e kësaj procedure për shkak të mungesës së transparencës në procesin e rekrutimit, vonesave të pajustificuara në publikimin e rezultateve të vlerësimit të testit me shkrim, si dhe mos publikimit të listës së kandidatit fitues në Simbnj. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar, dhe të rishqyrtoj ligjshmërinë e plotë të konkursit me numër reference RN00016741.

Duke qenë se kandidatja H.K-Sh si kandidate aplikuese, kishte parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kontestuar procedurën sipas konkursit me numër reference RN00016741, për pozitën e punës “Zyrtar për Regjistrim Civil” në Agjencinë e Regjistrimit Civil në Ferizaj, ndërsa, ky i fundit më Vendimin me numër A.nr.1888/2025, të datës 29.12.2025, kishte anuluar në tërësi procedurën e pranimit me numër reference RN00016741.

Andaj, referuar gjendjes së fakteve si më lartë dhe duke marrë parasysh se objekti i kontestit sipas ankesës A.nr.1868/2025, të datës 05.11.2025, ka të bëjë me procedurën e pranimit për të cilën Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vendosur në mënyrë meritore me Vendimin A.nr.1888/2025, të datës 29.12.2025, rrjedhimisht, ka anuluar në tërësi procedurën e rekrutimit, si një qëllim i propozuar edhe nga ankuesi në petitumin e ankesës, atëherë, mbi bazën e këtyre rrethanave, e në kuptim të dispozitave të nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative më të cilat është përcaktuar se: “Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kot”, Kolegji vlerëson se objekti i ankesës A.nr.1868/2025, është bërë i pamundur për shqyrtim dhe vendosje.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi që të përfundoj procedimin administrativ të filluar me ankesën A.nr.1868/2025, të datës 05.11.2025.

Kështu që, në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1868/2025

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- *Ankuesit, G.H;*
- *Njësisë se Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*